



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M  
K.P.P. 333/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.08.2020 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

**Objekt:** “Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Alstezo” sha në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur-Marrëveshje kuadër”, me nr. REF-56565-04-22-2020, me objekt Loti VIII “Riparim, mirëmbajtje automjetesh për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Sarandë”, me fond limit 4,968,474 lekë (pa TVSH), ”, me nr. REF-56567-04-22-2020, me objekt: Loti IX “Riparim, mirëmbajtje automjetesh për Drejtorinë e Spitalit Bashkiak “Ihsan Cabej” Lushnje”, me fond limit 4,048,050 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 26.05.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.”

**Ankimues:** “Alstezo” sha  
Lagjia: “Kryengritja e Fierit”, Rruga “Aulona”, Fier

**Autoriteti Kontraktor:** Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara  
Sheshi Skënderbej, nr. 3, Tiranë

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018,

datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 23.04.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur-Marrëveshje kuadër”, me nr. REF-56565-04-22-2020, me objekt Loti VIII “Riparim, mirëmbajtje automjetesh për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Sarandë”, me fond limit 4,968,474 lekë (pa TVSH), me nr. REF-56567-04-22-2020, me objekt: Loti IX “Riparim, mirëmbajtje automjetesh për Drejtorinë e Spitalit Bashkiak “Ihsan Cabej” Lushnje”, me fond limit 4,048,050 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 26.05.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

II.2. Në datën 26.05.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3 Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 11.06.2020

ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

Për Lotin VIII

- |                  |                              |
|------------------|------------------------------|
| 1. “Alstezo” sha | 3.973.590 lekë, skualifikuar |
| 2. “Kadiu” sha   | 4.187.480 lekë, skualifikuar |

Për Lotin IX

- |                                 |                              |
|---------------------------------|------------------------------|
| 1. “Alstezo” sha                | 3.243.670 lekë, skualifikuar |
| 2. “Auto Manoku Servis” sh.p.k. | 3.628.660 lekë, skualifikuar |
| 3. “Kadiu” sha                  | 3.664.320 lekë, skualifikuar |

II.4. Në datën 11.06.2020 operatori ekonomik “Alstezo” sha është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyetimin si më poshtë:

Për Lotin VIII

- 1. Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 1 të Kritereve të Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit pasi “Deklarata mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme” nuk është sipas formës së përcaktuar në DT për pikën 3 të saj.*
- 2. Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 1 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, ISO 9001 (e vlefshme)ose ekuivalente të tij për pikën e autoservisit ne vlorë. Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit te shëndetit dhe sigurisë në punë, OHSAS 18001 (e vlefshme) ose ISO 45001 (e vlefshme)ose ekuivalente të tij për pikën e autoservisit ne vlorë. Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 3 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të mjedistit, ISO 14001(e vlefshme)ose ekuivalente të tij për pikën e autoservisit ne vlorë.*
- 3. Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 4 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Licenca VII 3B 1(a,b,c,ç) per servisin Qarkun e vlorë.*
- 4. Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 6 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Leje mjedisit e tipit B për servisin në qarkun e vlorë*

Për Lotin IX

- 1. Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 1 të Kritereve të Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit pasi “Deklarata mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme” nuk është sipas formës së përcaktuar në DT për pikën 3 të saj.*

2. *Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 6 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Leje mjedisit e tipit B për servisin në qarkun e Fier.*

II.5. Në datën 15.06.2020 operatori ekonomik “Alstezo” sha ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, me arsyetimin si më poshtë vijon:

#### *Për Lotin VIII*

*[...]Kemi marre pjese ne proceduren e zhvilluar nga AK Agjensia e Blerjeve te Perqendruara me dt.26.05.2020 Per Lotin VIII Riparim, mirembajtje automjetesh per Drejtorine e Sherbimit Spitalor Sarande. Fond Limit: 4,968,474 (kater milion e nenteqind e gjashtedhete e tete rniye e katerqind e shtatedhete e kater) leke pa TVSH. Jemi njohur ne Sistemin elektronik te Prokurimit Publik me klasifikimin e ofertave me dt.11.06.2020, ne te cilin ne si Operator Ekonomik jemi skualifikuar me arsyetimin, si vijon:*

*1.Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 1 të Kriterëve të Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit pasi “Deklarata mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme” nuk është sipas formës së përcaktuar në DT për pikën 3 të saj.*

*2.Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 1 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqerisë, ISO 9001 (e vlefshme)ose ekuivalente të tij për pikën e autoservisit ne vlorë. Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit te shëndetit dhe sigurisë në punë, OHSAS 18001 (e vlefshme) ose ISO 45001 (e vlefshme)ose ekuivalente të tij për pikën e autoservisit ne vlorë. Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 3 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të mjedistit, ISO 14001(e vlefshme)ose ekuivalente të tij për pikën e autoservisit ne vlorë.*

*3.Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 4 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Licenca VII 3B 1(a,b,c,ç) per servisin Qarkun e vlorë.*

*4.Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 6 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Leje mjedisit e tipit B për servisin në qarkun e vlorë.*

*E kundërshtojme kete klasifikim te bere nga AK, lidhur me skualifikimin ofertës tonë të paraqitur në këtë procedurë prokurimi, me arsyetimin si vijon:*

1. *Lidhur me pretendimin që “Deklarata mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme” nuk është sipas formës së përcaktuar në DT, theksojmë që dokumenti i dorëzuar sëbashku me ofertën në plotësim të kësaj kërke nga ana jonë si oe në këtë procedurë prokurimi është konform shtojcës 7 të dokumentave Standarte (DST) të publikura nga APP për procedrën e hapur Shërbime” bashkëngjitur dokumentii paraqitur në plotësimin e kësaj kërkesë në SPE të APP-së.*
2. *Lidhur me pretendimin që Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 1 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqerisë, ISO 9001 (e vlefshme)ose ekuivalente të tij për pikën e autoservisit ne vlorë. Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2 të kapacitetit*

*ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, OHSAS 18001 (e vlefshme) ose ISO 45001 (e vlefshme)ose ekuivalente të tij për pikën e autoservisit ne vlorë. Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 3 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të mjedisit, ISO 14001(e vlefshme)ose ekuivalente të tij për pikën e autoservisit ne Vlorë.*

*Ky pretendim nuk qëndron, pasi nga ana jonë si oe , bashkë me ofertën kemi paraqitur:*

*Çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, ISO 9001:2015(e vlefshme)*

*Çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, ohsas 18001 ( e vlefshme)*

*Çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të mjedisit, ISO 14001( e vlefshme).*

*Sqarojmë se Çertifikatat e mësipërme jepen për të gjithë aktivitetin e shoqërisë”Alstezo” sha, dhe nuk janë të përcaktuara në veçanti për çdo vendodhje të veprimtarisë ku ushtrohet ky aktivitet (bashkëngjitur dokumentat përkatës sa më sipër të paraqitura në plotësim të kësaj kërkesë në SPE të APP).*

*3. Lidhur me pretendimin që Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 4 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Licenca VII 3B 1(a,b,c,ç) per servisin Qarkun e Vlorë sqarojmë si më poshtë vijon:*

*Në kriteret e veçanta të kualifikimit për këtë lot është kërkuar si vijon:*

*Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencën VII.3.B.1, për pikat a, b, c, ç, sipas udhëzimit nr. 1546, datë 29.03.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”*

*Në plotësimin e këtij kriteri nga ana jonë janë paraqitur liçencat përkatëse për ushtrimin e aktivitetit të autoriparimit sikurse kërkohet në dt. (bashkëngjitur dokumentat përkatës sa më sipër të paraqitura në plotësimin të kësaj kërkesë në SPEtë APP)*

*Sa më sipër pretendimi në lidhje me këtë pikë nuk qëndron.*

*4. Lidhur me pretendimin që për pikën 3 dt,- Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 6 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Leje mjedisit e tipit B për servisin në qarkun e vlorë*

*Në dst shtojca 8 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit kërkohet si vijon : Operatori ekonomik ofertues, në lidhje me repartin e bojatisjes së mjeteve, duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të tipit B, Kodi III.1.B, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet. Në plotësimin ekësaj pie kemi paraqitur Liçencën mjedisore të tipit B, Kodi III 1.B. (bashkëngjitur dokumenti sa më sipër të paraqitura në plotësimin të kësaj kërkesë në SPEtë APP). Ndërkohë në pikën 3.3. kapaciteti teknik kërkohet: 5.Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon të paktën 1 (një) ambient sipërfaqe minimale 100 m2, ku ushtron veprimtarine për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, brenda qarku Vlorë, Sa më sipër sqarojm AK në kërkesën e saj për servis është shprehur qartë që kërkon: 5.Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon të paktën 1*

(një) ambient sipërfaqe minimale 100 m<sup>2</sup>, ku ushtron veprimtarinë për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, brenda qarku Korçë.... dhe për këtë pikë neplotësojmë kur kemi paraqitur dokumentacionin e kontratës së qirasë së servisit në Qarkun e Vlorës.

Ndrësa përsa i përket bojatisjes së mjeteve AK është shprehur qartë në kërkesën e tij që: 6. Operatori ekonomik ofertues, në lidhje me repartin e bojatisjes së mjeteve, duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të tipit B, Kodi III.1.B, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet. Por në asnjë rast nuk është shprehur që ky repart të jetë në Qarkun Vlorë pasi ky repart është një reapt i veçantë dhe i specializuar, i cili shërben vetëm në rastet e bojatisjes së mjeteve. Ndërkohë ne si oe e kemi këtë repart dhe njëkohësisht jemi të pajisur me leje mjedisi të tipit B, Kodi II.1.B. sikurse kërkohet në DST nga ana e AK. Sa i përket transportit të mjeteve për kryerje e procesit të lyerjes së mjeteve, ne si oe duke qënë se ky është një repart i specializuar, në çdo rast që lind nevoja bëjmë të mundur transportin e mjeteve me karrotrec, sikurse është kërkuar në DT për mjetet e difektuara me shpenzimet tona, gjë të cilin e kemi shprehur në deklaratën e kërkuar nga ana e AK dhe që shërben pikërisht edhe në plotësimin ekëtij kriteri (bashkëngjitur dokumentat përkatës sa më sipër të paraqitura në plotësimin të kësaj kërkesë në SPE të APP).

Sa më sipër pretendimi i AK në lidhje me këtë pikë nuk qëndron.

Në përfundim sa më sipër kërkojmë riklasifikim të ofertave duke bërë të mundur klasifikimin e ofertës sonë pasi i plotëson të gjitha kërkesat e vendosura nga AK në kushtet e veçanta të kualifikimit të paraqitura në dt.[...]

#### *Për Lotin IX*

Kemi marre pjese ne proceduren e zhvilluar nga AK Agjensia e Blerjeve te Perqendruara me dt.26.05.2020 Per Loti IX “Riparim, mirëmbajtje automjetesh për Drejtorinë e Spitalit Bashkiak “Ihsan Cabej” Lushnje”, me fond limit 4,048,050 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 26.05.2020, ne te cilin ne si Operator Ekonomik jemi skualifikuar me aresyetimin, si vijon:

1.Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 1 të Kriterëve të Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit pasi “Deklarata mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme” nuk është sipas formës së përcaktuar në DT për pikën 3 të saj.

2.Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 6 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Leje mjedisit e tipit B për servisn në qarkun e Fier.

E kundërshtojme kete klasifikim te bere nga AK, lidhur me skualifikimin ofertës tonë të paraqitur në këtë procedurë prokurimi, me arsyetimin si vijon:

1.Lidhur me pretendimin që “Deklarata mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme” nuk është sipas formës së përcaktuar në DT, theksojmë që dokumenti i dorëzuar sëbashku me ofertën në plotësim të kësaj kërkesë nga ana jonë si oe në këtë procedurë prokurimi është konform shtojcës 7 të dokumentave Standarte (DST) të publikura nga APP për procedrën e hapur Shërbime” bashkëngjitur dokumentii paraqitur në plotësimin e kësaj kërkesë në SPE të APP-së. Sa më siëpr pretendimi i AK-së nuk qëndron.

3.Lidhur me pretendimin që Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 6 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 6 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Leje mjedisit e tipit B për servisn në qarkun e Fier sqarojmë si më poshtë:

Në kriteret e veçanta të kualifikimit për këtë lot është kërkuar si vijon:

6.Operatori ekonomik ofertues, në lidhje me repartin e bojatisjes së mjeteve, duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të tipit B, Kodi III.1.B, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet.

Në plotësim të kësaj pike kemi paraqitur Lejen mjedisore tipi B Kodi III.1.B. (bashkëngjitur dokumenti i paraqitur në plotësimin e kësaj kërkesë në SPE TË App-SË.

Ndërkohë në pikën 3.3. Kapaciteti teknik kërkohet:

5.Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon të paktën 1 (një) ambient sipërfaqe minimale 100 m2, ku ushtron veprimtarinë për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, brenda qarku Fier,dhe për këtë pikë ne e plotësojmë kur kemi paraqitur dokumentacionin e pronësisës së servisit qarku Fier.

Ndërsa përsa i përket bojatisjes së mjeteve AK është shprehur qartë në kërkesën e tij që:

6. Operatori ekonomik ofertues, në lidhje me repartin e bojatisjes së mjeteve, duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të tipit B, Kodi III.1.B, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet.

Por në asnjë rast nuk është shprehur që ky repart të jetë patjetër në qarkun Fier, pasi ky repart është një repart i veçantë dhe i specializuar i cili shërben vetëm në rastet e bojatisjes së mjeteve. Ndërkohë ne si oe e kemi këtë repart dhe njëkohësisht jemi të pajisur me leje mjedisi të tipit B Kodi II.1.B. sikurse kërkohet në DST nga ana e AK. Sa i përket transportit të mjeteve për kryerjen e procesit të lyerjes së mjeteve, ne si oe duke qënë se ky është një reupart i specializuar, në çdo rast lind nevoja bëjmë të mundur transportin e mjeteve me karrotrec, sikurse është kërkuar në DT për mjetet e difektuara me shpenzimet tona, gjë të cilën e kemi shprehur në deklaratën e kërkuar nga ana e AK-së dhe që shërben pikërisht edhe në plotësimin e këtij kriteri (bashkëlidhur dokumenti i paraqitur në plotësimin të kësaj kërkesë në SPE të APP-së.[...]

Në përfundim sa më sipër kërkojmë riklasifikimin e ofertave duke bërë të mundur klasifikimin e ofertës tonë pasi i plotëso të gjitha kërkesat e vendosura nga AK në kushtet e veçanata të kualifikimit të paraqitura në DT.

II.6. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit më anë të shkresën nr.1088/2 prot, datë 22.06.2020, si dhe shkresës nr. 1087/3prot., datë 22.06.2020 i ka kthyer përgjigje

ankesës së operatorit ekonomik “Alstezo” sha duke e pranuar pjesërisht atë me pretendimin si më poshtë:

*Për Lotin VIII*

*[...]Me pretendimin si vijon: [ ... ] "Deklarata mbi permbushjen e kriterëve të përgjithshme" nuk është sipas formës së përcaktuar në DT, theksojmë që dokumenti i dorëzuar së bashku me ofertën në plotësim të kësaj kërkesë nga ana jone si OE në këtë procedurë prokurimi është konform Shtojcës 7, të dokumentave Standarte (DST) të publikuara nga APP për procedurën e hapur shërbime, (bashkëngjitur dokumenti i paraqitur në plotësim të kësaj kërkesë në SPE të APP). Sa me sipër pretendimi i AK në lidhje me këtë pikë nuk qëndron. "*

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vlerësimin e bëri në sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, dokumentet e dorëzuara nga ofertuesi "Alstezo" SHA, pretendimet e parashtruara në ankesë mbi skualifikimin e ofertës së tij konstatoi se:*

*Per ofertuesin "Alstezo" SHA, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka njoftuar dhe dhënë automatikisht nepermjet sistemit të prokurimit elektronik me datë 11.06.2020, arsyet e skualifikimit të tij si vijon: "Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 1 të Kriterëve të Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit pasi "Deklarata mbi permbushjen e kriterëve të përgjithshme" nuk është sipas formës së përcaktuar në DT për pikën 3 të saj. "*

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, verifikoi në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertës ekonomike nga Ofertuesi "Alstezo" SHA dhe konstatoi:*

*Në dokumentat e tenderit në Shtojcën Nr.8 "Kriteret e Përgjithshme të pranimit/Kualifikimit", pika 1 në shënimin përcaktohet se këto kriterë duhet të plotësohen me dorëzimin e vetedeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 7.*

*Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga ofertuesi "Alstezo" SHA rezulton se në përmbushje të kriterit të përcaktuar ofertuesi ka dorëzuar "Deklaratën mbi përmbushjen e kriterëve të Përgjithshme", Nga verifikimi i deklaratës së dorëzuar rezulton se ofertuesi ndër të tjera ka deklaruar : "Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyresit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: Albert Zogo, Aurora Zogo, Andi Zogo, Enea Zogo nuk janë ose kanë qenë të denuar me vendim gjyqësor të formës së prirë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP.*

*Në shtojcën 7 Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme*

*1. Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyresit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:*

	<i>Emër (Emrat)</i>	<i>Mbiemër</i>	<i>Datëlindje ditë muaj vit</i>	<i>Atësi</i>	<i>Amësi</i>	<i>Vendlindje</i>
<i>1</i>						
<i>2</i>						



3						
---	--	--	--	--	--	--

*nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP.*

*Dokumentacioni i dorezuar nga ofertuesi nuk është dorezuar në formatin e duhur sipas shtojcës nr. 7 të dokumentave të tenderit për pikën 3 të saj, pasi nuk janë plotësuar të dhënat sipas tabelës. Pavarësisht këtij fakti, tabela është shtuar nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara dhe ofertuesi i ka deklaruar emrat e të gjithë ortakeve dhe administratorëve, duke mundësuar verifikim.*

*Per arsyet e më sipërme pretendimi i ofertuesit "Alstezo" SHA pranohet.*

*2.Ofertuesi "Alstezo" SHA ka ankimuar skualifikimin për mospërbushjen e kriterit në Shtojcën Nr.8 "Kriteret e Vecanta të kualifikimit" seksioni 3.1 "Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike" pikat 1,2,3 në dokumentet e tenderit ku përcaktohet: 1.Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, ISO 9001 (e vlefshme)ose ekuivalente të tij. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë.*

*2.Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, OHSAS 18001 (e vlefshme) ose ISO 45001 (e vlefshme)ose ekuivalente të tij. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë.*

*3.Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të mjedistit, ISO 14001(e vlefshme)ose ekuivalente të tij. Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë.*

*Me pretendimin si vijon: [...] "Ky pretendim nuk qendron, pasi nga ana jone si OE, bashkë me ofertën kemi paraqitur certifikate që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, ISO 9001:2015(e vlefshme), certifikate që vërteton cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, OHSAS 18001 (e vlefshme), certifikate që vërteton cilësinë e menaxhimit të mjedistit, ISO 14001(e vlefshme). Sqarojme se certifikatat e më sipërme jepen për të gjithë Aktivitetin e Shoqërisë Alstezo sha me NIPT J63208420N dhe nuk jepen të përcaktuara në vecanti për çdo vendodhje të veprimtarisë ku ushtrohet ky aktivitet (bashkëngjitur dokumentat përkatëse sa më sipër të paraqitura në plotësim të kësaj kërkesë në SPE të APP.) Sa më sipër pretendimi i AK në lidhje me këto pike nuk qendron. "*

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vlerësimin e tyre në sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, dokumentet e dorëzuara nga ofertuesi "Alstezo" SHA, pretendimet e parashtruara në ankese mbi skualifikimin e ofertës së tij konstatoi se:*

*Per ofertuesin "Alstezo" SHA, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka njoftuar dhe dhënë automatikisht nepermjet sistemit të prokurimit elektronik me datë 11.06.2020, arsyet e skualifikimit të tij si vijon: 2.Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 1 të kapacitetit*

ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqerisë, ISO 9001 (e vlefshme) ose ekuivalente të tij për pikën e autoservisit ne vlorë. Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit te shëndetit dhe sigurisë në punë, OHSAS 18001 (e vlefshme) ose ISO 45001 (e vlefshme) ose ekuivalente të tij për pikën e autoservisit ne vlorë. Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 3 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të mjedistit, ISO 14001 (e vlefshme) ose ekuivalente të tij për pikën e autoservisit ne vlorë.

Ne dokumentat e tenderit ne Shtojcën Nr.8 "Kriteret e Vecanta te kualifikimit" seksioni

3.1 "Kapaciteti ligjor/prefesional i operatoreve ekonornike" pikat 1,2,3 percaktohet qe Operatori ekonomik duhet te paraqese Certifikate qe verteton cilesine e menaxhimit te shoqerise, ISO 9001 (e vlefshme) ose ekuivalente te tij. Certifikata te jete e leshuar nga nje organ i vleresirnit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kornbetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues, te njohura nga Republika e Shqiperise.; Operatori ekonomik duhet te paraqese Certifikate qe verteton cilesine e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune, OHSAS 18001 (e vlefshme) ose ISO 45001 (e vlefshme) ose ekuivalente te tij. Certifikata te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kornbetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues, te njohura nga Republika e Shqiperise.; Operatori ekonomik duhet te paraqese Certifikate qe verteton cilesine e menaxhimit te mjedistit, ISO 14001 (e vlefshme) ose ekuivalente te tij. Certifikata te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konfonnitetit, i akredituar nga organizmi kornbetar i akreditimit ose organizma nderkornbetar akreditues, te njohura nga Republika e Shqiperise.

Nga verifikimi i dokumentacionit te dorezuar ne sistemin e prokurimit elektronik rezulton se ofertuesi "Alstezo" SHA ne permbshje te kriterit te percaktuar, ka dorezuar EN-ISO 9001:2015 per sistemin e manaxhimit te cilesis, EN-ISO 14001:2015 per sistem menaxhimi mjedisor, EN-ISO 18001 :2007 per sistemin e menaxhimit dhe sigurie ne pune, Nga verifikimi i ISO-ve rezulton se ato jane te vlefshme dhe te leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkornbetar akreditues, te njohura nga Republika e Shqiperise.

Kriteret e vecanta per kualifikim kane si synim kryesor qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatoreve ekonomike, te cilet nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithcka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates, Ne varesi te kontrates dhe volumit te saj autoriteti kontraktor percakton kerkesat e vecanta per kualifikim, te cilat jane te detyrueshme per t'u permbushur nga operatoret ekonomik pjesernarres ne procedurat e prokurimit. Operatoret Ekonornike jane te detyruar te pergatisin ofertat ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumenta duhet te refuzohen si te papranueshme bazuar dhe ne piken 1, te nenit 46 te Ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar ku citohet: "Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedural e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret e meposhtme, qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

Dokumentacioni i dorezuar nga ofertuesi rezulton te jete ne permbushje te kriterit te percaktuar ne dokumentat e tenderit.

Per arsyet e me siperme pretendimi i ofertuesit "Alstezo" SHA pranohet.

3.Ofertuesi "Alstezo" sha ka ankimuar skualifikimin per mospermbushjen e kriterit ne Shtojcen Nr.8 "Kriteret e Vecanta te kualifikimit" seksioni 3.1 "Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike" piken 4 ne dokumentet e tenderit ku percaktohet: 4. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencën VII.3.B.1, për pikat a, b, c, ç, sipas udhëzimit nr. 1546, datë 29.03.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vleresimin e here ne sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave, dokumentet e dorezuara nga ofertuesi "Alstezo" SHA, pretendimet e parashtruara ne ankese mbi skualifikimin e ofertes se tij konstatoi se:

Per ofertuesin "Alstezo" SHA, Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka njoftuar dhe dhene automatikisht nepermjet sistemit te prokurimit elektronik me date 11.06.2020, arsyet e skualifikimin te tij si vijon: "Operatori ekonomik nuk permbush piken 4 te kapacitetit ligjor/profesional i operatoreve ekonomik pasi nuk arriti te paraqese Licenca VII 3B 1 (a.b.c.c) per servisin ne Qarkun e Vlores. "

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, verifikoi në sistemin e prokurimeve elektronike dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga Ofertuesi "Alstezo" SHA dhe konstatoi:

Ne dokumentat e tenderit ne Shtojcen Nr.8 "Kriteret e Vecanta te kualifikimit", seksioni 3.1 "Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike", piken 4 percaktohet se operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur me licencen VII.3.B.1, per pikat a, b, c, r;, sipas udhezimit nr. 1546, date 29.03.2016 "Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove".

Nga verifikimi ne sistemin e prokurimit elektronik rezulton se ofertuesi "Alstezo" SHA ne permbushje te kriterit te percaktuar ka dorezuar licensat LN-4699-03-2018 Kadi VII.3.B.1 me vend te kryrjes se veprimtarise Lagjia Kryengritja e Fierit dhe LN-2473-12-2016 Kodi VII.3.B.1 me vend te kryrjes se veprimtarise "Autostrada Tirane-Durres", km 7. Licensat jane me emertim pershkrues te veprimtarise, per pikat a.b.c.ç sipas udhezimit nr.1546, date 29.03.2016 "Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove" më konkretisht Riparimi dhe mirëmbajtja e karrocërisë të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, Riparimi dhe mirëmbajtja e impiantit elektrik të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, Riparim dhe mirëmbajtja e gomave të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove.

Kriteret e vecanta per kualifikim kane si synim kryesor qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatoreve ekonomike, te cilet nepermjet dokumentacionit te

paraqitur duhet te vertetohet se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithcka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates, Ne varesi te kontrates dhe volumit te saj autoriteti kontraktor percakton kerkesat e vecanta per kualifikim, te cilat jane te detyrueshme per t'u permbushur nga operatoret ekonomik pjesernarres ne procedurat e prokurimit. Operatoret Ekonomike jane te detyruar te pergatisin ofertat ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumenta duhet te refuzohen si te papranueshme bazuar dhe ne piken 1, te nenit 46 te Ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar ku citohet: "Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedural e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret e meposhtme, qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e percaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..."

Për arsyet e mësipërme pretendimi i "Alstezo" sha pranohet.

4.Ofertuesi "Alstezo" SHA ka ankimuar skualifikimin per mospermbushjen e kriterit ne Shtojcen Nr.8 "Kriterete Vecanta te kualifikimit" seksioni 3.1 "Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike" piken 6 ne dokumentet e tenderit ku percaktohet: "Operatori ekonomik ofertues, ne lidhje me repartin e bojatisjes se mjeteve, duhet te jete i pajisur me leje mjedisore te tipit B, Kodi III I.B, leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB), per vendin ku ushtron kete aktivitet. " Me pretendimin si vijon: [...] Në dst shtojca 8 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit kërkohet si vijon : Operatori ekonomik ofertues, në lidhje me repartin e bojatisjes së mjeteve, duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të tipit B, Kodi III.1.B, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet. Në plotësimin ekësaj pie kemi paraqitur Liçencën mjedisore të tipit B, Kodi III I.B. (bashkëngjitur dokumenti sa më sipër të paraqitura në plotësimin të kësaj kërkesë në SPE të APP). Ndërkohë në pikën 3.3. kapaciteti teknik kërkohet: 5.Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon të paktën 1 (një) ambient sipërfaqe minimale 100 m2, ku ushtron veprimtarine për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, brenda qarku Vlorë, Sa më sipër sqarojm AK në kërkesën e saj për servis është shprehur qartë që kërkon: 5.Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon të paktën 1 (një) ambient sipërfaqe minimale 100 m2, ku ushtron veprimtarine për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, brenda qarku Korçë.... dhe për këtë pikë ne e plotësojmë kur kemi paraqitur dokumentacionin e kontratës së qirasë së servisit në Qarkun e Vlorës.

Ndwrsa përrsa i përket bojatisjes së mjeteve AK është shprehur qartë në kërkesën e tij që: 6.Operatori ekonomik ofertues, në lidhje me repartin e bojatisjes së mjeteve, duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të tipit B, Kodi III.1.B, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet. Por në asnjë rast nuk është shprehur që ky repart të jetë në Qarkun Vlorë pasi ky repart është një repart i veçantë dhe i specializuar, i cili shërben vetëm në rastet e bojatisjes së mjeteve. Ndërkohë ne si operator ekonomik e kemi këtë repart dhe njëkohësisht jemi të pajisur me leje mjedisi të tipit B, Kodi II.1.B. sikurse kërkohet në DST nga ana e AK. Sa i përket transportit të mjeteve

për kryerje e procesit të lyerjes së mjeteve, ne si oe duke qënë se ky është një repart i specializuar, në çdo rast që lind nevoja bëjmë të mundur transportin e mjeteve me karrotrec, sikurse është kërkuar në DT për mjetet e difektuara me shpenzimet tona, gjë të cilin e kemi shprehur në deklaratën e kërkuar nga ana e AK dhe që shërben pikërisht edhe në plotësimin ekëtij kriteri (bashkëngjitur dokumentat përkatës sa më sipër të paraqitura në plotësimin të kësaj kërkesë në SPE të APP). Sa më sipër pretendimi i AK në lidhje me këtë pikë nuk qëndron. Në përfundim sa më sipër kërkojmë riklasifikim të ofertave duke bërë të mundur klasifikimin e ofertës sonë pasi i plotëson të gjitha kërkesat e vendosura nga AK në kushtet e veçanta të kualifikimit të paraqitura në dt.[...]

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vleresimin e here ne sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vleresimit të Ofertave, dokumentet e dorezuara nga ofertuesi "Alstezo" SHA, pretendimet e parashtruara ne anekese mbi skualifikimin e ofertes se tij konstatoi se:

Per ofertuesin "Alstezo" SHA, Komisioni i Vleresimit të Ofertave ka njoftuar dhe dhene automatikisht neperrnjete sistemit te prokurimit elektronik me date 11.06.2020, arsyet e skualifikimit te tij si vijon: "Operatori ekonomik nuk permbush piken 6 te kapacitetit ligjor/profesional i operatoreve ekonomik pasi nuk arriti te paraqese Leje mjedisit e tipit B per servisin ne Qarkun e Vlores."

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga Ofertuesi "Alstezo" SHA dhe konstatoi:

Ne dokumentat e tenderit ne Shtojcen Nr.8 "Kriteret e Vecanta te kualifikimit" seksioni 3.1 "Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike" piken 6 percaktohet se operatori ekonomik ofertues, ne lidhje me repartin e bojatisjes se mjeteve, duhet te jete i pajisur me leje mjedisore te tipit B, Kodi III.1.B, leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB), per vendin ku ushtron kete aktivitet.

Nga verifikimi ne sistemin e prokurimit elektronik rezulton se ofertuesi "Alstezo" SHA ka dorezuar ne permbushje te kriterit Lejen PN-3514-08-2016 Kodi III.LB me emertim pershkruet te veprimtarise, Leje mjedisi e tipit B per Ringjyrosje ose rispucim i mjeteve te transportit rrugor ose pjeseve te tyre; Lyrja dhe lustrimi i makinave; Riparimi i pajisjeve motorike dhe motocikletave; Larje dhe pastrim mjetesh motorike , me vend te kryrjes se veprimtarise, njesia administrative kashar "Autostrada Tirane-Durres" km 7.

Kriteret e vecanta per kualifikim kane si synim kryesor qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatoreve ekonomike, te cilet nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithcka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates, Ne varesi te kontrates dhe volumit te saj autoriteti kontraktor percakton kerkesat e vecanta per kualifikim, te cilat jane te detyrueshme per t'u permbushur nga operatoret ekonomik pjesernarres ne procedurat e prokurimit. Operatoret Ekonomike jane te detyruar te pergatisin ofertat ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumenta duhet te refuzohen si te papranueshme bazuar dhe ne piken 1, te nenit 46 te Ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar ku citohet: "Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedural e prokurimit, duhet

te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret e meposhtme, qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuose.

Ne nenin 20, pika 2 e ligjit nr.10448, date 14.7.2011 "Per lejet e mjedisit", percaktohet se: "2.E njejta leje mjedisi e tipit B mund te lejoje funksionimin e me shume se nje instalimi te te njejtin operator, ne te njeften vendndodhje. Instalimet e operatoreve te ndryshem, qe ndodhen ne te njeften vendndodhje dhe instalimet e të njëjtin operator, që ndodhen ne vendndodhje te ndryshme kërkojnë leje të veçanta të tipit A,B apo C, sipas rastit.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...". Për arsyet e mësipërme pretendimi i ofertuesit "Alstezo" sha nuk pranohet.

Sa më sipër ju bëjmë me dije se kundër vendimit të organit qëndror blerës mund të bëhet ankim në KPP në përputhje me nenin 63 pika 6 , të LPP[...]

Për Lotin IX

[...]Me pretendimin si vijon: [...] "Deklarata mbi permbushjen e kriterëve te pergjithshme" nuk eshte sipas formes se percaktuar ne DT, theksojme qe dokumenti i dorezuar se bashku me oferten ne plotesim te kesaj kerkese nga ana jone si OE ne kete procedure prokurimi eshte konform Shtojces 7, te dokumentave Standarte (DST) te publikuara nga APP per proceduren e hapur sherbime, (bashkengjitur dokumenti i paraqitur ne plotesim te kesaj kerkese ne SPE te APP). Sa me siper pretendimi i AK ne lidhje me kete pike nuk qendron. "

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vleresimin e bere ne sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave, dokumentet e dorezuara nga ofertuesi "Alstezo" SHA, pretendimet e parashtruara ne ankese mbi skualifikimin e ofertes se tij konstatoi se:

Per ofertuesin "Alstezo" SHA, Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka njoftuar dhe dhene automatikisht nepermjet sistemit te prokurimit elektronik me date 11.06.2020, arsyet e skualifikimin te tij si vijon: "Operatori ekonomik nuk permbush piken 1 te Kriterëve te Pergjithshme te Pranimit/Kualifikimit pasi "Deklarata mbi permbushjen e kriterëve te pergjithshme" nuk eshte sipas formes se percaktuar ne DT per piken 3 te saj. "

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga Ofertuesi "Alstezo" SHA dhe konstatoi:

Ne dokumentat e tenderit ne Shtojcen Nr.8 "Kriteret e Pergjithshme te pranim/Kualifikimit", pika 1 ne shenimin percaktohet se keto kriteret duhet te plotesohen me dorezimin e vetedeklarates me shkrim te subjektit, ne ditën e hapjes se ofertes, sipas Shtojces 7.

Nga verifikimi i dokumentacionit te dorezuar ne sistemin e prokurimit elektronik nga ofertuesi "Alstezo" SHA rezulton se ne perpmushje te kriterit te percaktuar ofertuesi ka dorezuar "Deklaraten mbi permbushjen e kriterëve te Pergjithshme", Nga verifikimi i deklarates se dorezuar rezulton se ofertuesi nder te tjera ka deklaruar : "Personi/at ne cilesine e anetarit te organit administrativ, drejtuesit ose mbikeqyresit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca perfaqesuese, vendimmarrjeje

ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si me poshte: Albert Zogo, Aurora Zogo, Andi Zogo, Enea Zogo nuk jane ose kane qene te denuar me vendim gjyqesor te formes se prere per asnje nga veprat penale, te percaktuara ne nenin 45/1 te LPP.

Në shtojcën 7 Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme

2. Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

	Emër (Emrat)	Mbiemër	Datëlindje ditë muaj vit	Atësi	Amësi	Vendlindje
1						
2						
3						

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të percaktuara në nenin 45/1 të LPP.

Dokumentacioni i dorezuar nga ofertuesi nuk është dorezuar në formatin e duhur sipas shtojcës nr. 7 të dokumentave të tenderit për pikën 3 të saj, pasi nuk janë plotësuar të dhënat sipas tabelës. Pavarësisht këtij fakti, tabela është shtuar nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara dhe ofertuesi i ka deklaruar emrat e të gjithë ortakëve dhe administratorëve, duke mundësuar verifikim.

Per arsyet e më sipërme pretendimi i ofertuesit "Alstezo" SHA pranohet.

2. Ofertuesi "Alstezo" SHA ka ankimuar skualifikimin për mospërmbushjen e kriterit në Shtojcën Nr.8 "Kriterete Vecanta të kualifikimit" seksioni 3.1 "Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike" pikën 6 në dokumentet e tenderit ku përcaktohet: "Operatori ekonomik ofertues, në lidhje me repartin e bojtisjes së mjeteve, duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të tipit B, Kodi III l.B, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këto aktivitete." Me pretendimin si vijon: [...] Në dst shtojca 8 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit kërkohet si vijon: Operatori ekonomik ofertues, në lidhje me repartin e bojtisjes së mjeteve, duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të tipit B, Kodi III.1.B, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këto aktivitete. Në plotësimin e kësaj pike kemi paraqitur Lejen mjedisore të tipit B, Kodi III 1.B. (bashkëngjitur dokumenti sa më sipër të paraqitura në plotësimin të kësaj kërkesë në SPETë APP). Ndërkohë në pikën 3.3. kapaciteti teknik kërkohet: 5. Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon të paktën 1 (një) ambient sipërfaqe minimale 100 m2, ku ushtron veprimtarinë për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, brenda qarku Fier, Sa më sipër sqarojmë AK në kërkesën e saj për servis është shprehur qartë që kërkon: 5. Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon të paktën 1 (një) ambient sipërfaqe minimale 100 m2, ku ushtron veprimtarinë për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, brenda qarku fier.... dhe për këtë pikë ne e plotësojmë kur kemi paraqitur dokumentacionin e kontratës së qirasë së servisit në Qarkun e Fier, pasi ky repart është një repart i veçantë dhe i specializuar, i cili shërben vetëm në rastet e bojtisjes së mjeteve. Ndërkohë ne si o.e. kemi këtë repart dhe njëkohësisht jemi të pajisur me leje mjedisore të tipit B, Kodi

*II.1.B. sikurse kërkohet në DST nga ana e AK. Sa i përket transportit të mjeteve për kryerje e procesit të lyerjes së mjeteve, ne si oe duke qënë se ky është një repart i specializuar, në çdo rast që lind nevoja bëjmë të mundur transportin e mjeteve me karrotrec, sikurse është kërkuar në DT për mjetet e difektuara me shpenzimet tona, gjë të cilin e kemi shprehur në deklaratën e kërkuar nga ana e AK dhe që shërben pikërisht edhe në plotësimin ekëtij kriteri (bashkëngjitur dokumentat përkatës sa më sipër të paraqitura në plotësimin të kësaj kërkesë në SPE të APP). Sa më sipër pretendimi i AK në lidhje me këtë pikë nuk qëndron. Në përfundim sa më sipër kërkohet riklasifikim të ofertave duke bërë të mundur klasifikimin e ofertës sonë pasi i plotëson të gjitha kërkesat e vendosura nga AK në kushtet e veçanta të kualifikimit të paraqitura në dt.[...]*

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vlerësimin e here në sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, dokumentet e dorëzuara nga ofertuesi "Alstezo" SHA, pretendimet e parashtruara në ankesë mbi skualifikimin e ofertës se tij konstatoi se:*

*Per ofertuesin "Alstezo" SHA, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka njoftuar dhe dhene automatikisht neperrnjët sistemit të prokurimit elektronik me date 11.06.2020, arsytet e skualifikimit të tij si vijon: "Operatori ekonomik nuk përmbush piken 6 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatoreve ekonomik pasi nuk arriti të paraqese Leje mjedisit e tipit B për servisn në Qarkun e Fier."*

*paraqitur si pjese e ofertës ekonomike nga Ofertuesi "Alstezo" SHA dhe konstatoi:*

*Ne dokumentat e tenderit në Shtojcën Nr.8 "Kriteret e Vecanta të kualifikimit" seksioni 3.1 "Kapaciteti ligjor/prefesional i operatoreve ekonomike" piken 6 përcaktohet se operatori ekonomik ofertues, në lidhje me repartin e bojatisjes së mjeteve, duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të tipit B, Kodi III.1.B, leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet.*

*Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik rezultoi se ofertuesi "Alstezo" SHA ka dorëzuar në përmbushje të kriterit Lejen PN-3514-08-2016 Kodi III.LB me emërtim përshkrues të veprimtarisë, Leje mjedisi e tipit B për Ringjyrosje ose rripucim i mjeteve të transportit rrugor ose pjesëve të tyre; Lyrja dhe lustrimi i makinave; Riparimi i pajisjeve motorike dhe motocikletave; Larje dhe pastrim mjetësh motorike, me vend të kryerjes së veprimtarisë, njësi administrative kashar "Autostrada Tirane-Durres" km 7.*

*Kriteret e vecanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatoreve ekonomike, të cilët nepërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zoterojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makinerite, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varesi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e vecanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomik pjesëtarës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme bazuar dhe në piken 1, të nenit 46 të Ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar ku citohet: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të*



kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret e meposhtme, qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuose.

Ne nenin 20, pika 2 e ligjit nr.10448, date 14.7.2011 "Per lejet e mjedisit", percaktohet se: "2.E njejta leje mjedisi e tipit B mund te lejoje funksionimin e me shume se nje instalimi te te njejtin operator, ne te njejtin vendndodhje. Instalimet e operatoreve te ndryshem, qe ndodhen ne te njejtin vendndodhje dhe instalimet e të njëjtin operator, që ndodhen ne vendndodhje te ndryshme kërkojnë leje të veçanta të tipit A,B apo C, sipas rastit.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...". Për arsyet e mësipërme pretendimi i ofertuesit "Alstezo" sha nuk pranohet.

Sa më sipër ju bëjmë me dije se kundër vendimit të organit qëndror blerës mund të bëhet ankim në KPP në përputhje me nenin 63 pika 6 , të LPP[...]

II.7. Në datën 29.06.2020 operatori ekonomik "Alstezo" sha ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke pretenduar si më poshtë:

*Për Lotin VIII*

[...]Kemi marre pjese ne proceduren e zhvilluar nga AK Agjensia e Blerjeve te Perqendruara me dt.26.05.2020 Per Lotin VIII Riparim, mirembajtje automjetesh per Drejtorine e Sherbimit Spitalor Sarande .Fond Limit: 4,968,474 (kater milion e nenteqind e gjashte - dhjete e tete mije e katerqind e shtatedhjete e kater) leke pa TVSH

Jemi njohur ne Sistemin elektronik te Prokurimit Publik me klasifikimin e ofertave me dt.11.06.2020, ne te cilin ne si Operator Ekonomik jemi skualifikuar me aresyetimin, si vijon:

1.Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 1 të Kriterëve të Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit pasi "Deklarata mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme" nuk është sipas formës së përcaktuar në DT për pikën 3 të saj.

2.Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 1 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, ISO 9001 (e vlefshme)ose ekuivalente të tij për pikën e autoservisit ne vlorë. Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit te shëndetit dhe sigurisë në punë, OHSAS 18001 (e vlefshme) ose ISO 45001 (e vlefshme)ose ekuivalente të tij për pikën e autoservisit ne vlorë. Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 3 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të mjedistit, ISO 14001(e vlefshme)ose ekuivalente të tij për pikën e autoservisit ne vlorë.

3.Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 4 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Licenca VII 3B 1(a,b,c,ç) per servisin Qarkun e vlorë.

4.Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 6 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Leje mjedisit e tipit B për servisin në qarkun e vlorë.

Klasifikimin e mësipërm e kemi kundështuar në AK, nëpërmjet Ankimimit tonë me nr. 15/1prot datë 15.06.2020, të dorëzuar në AKmë datë 15.06.2020, Nr. 4 prot., i lidhur me skualifikimine ofertës tonë të paraqitur në këtë procedurë prokurimi me arsyetimin si vijon:

1.Lidhur me pretendimin që “Deklarata mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme” nuk është sipas formës së përcaktuar në DT, theksojmë që dokumenti i dorëzuar sëbashku me ofertën në plotësim të kësaj kërke nga ana jonë si oe në këtë procedurë prokurimi është konform shtojcës 7 të dokumentave Standarte (DST) të publikura nga APP për procedrën e hapur Shërbime” bashkëngjitur dokumentii paraqitur në plotësimin e kësaj kërke në SPE të APP-së.

2.Lidhur me pretendimin që Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 1 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, ISO 9001 (e vlefshme)ose ekuivalente të tij për pikën e autoservisit ne vlorë. Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 2 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit te shëndetit dhe sigurisë në punë, OHSAS 18001 (e vlefshme) ose ISO 45001 (e vlefshme)ose ekuivalente të tij për pikën e autoservisit ne vlorë. Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 3 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të mjedisit, ISO 14001(e vlefshme)ose ekuivalente të tij për pikën e autoservisit ne Vlorë.

Ky pretendim nuk qëndron, pasi nga ana jonë si oe , bashkë me ofertën kemi paraqitur:

Çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, ISO 9001:2015(e vlefshme)

Çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, ohsas 18001 ( e vlefshme)

Çertifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të mjedisit, ISO 14001( e vlefshme).

Sqarojmë se Çertifikatat e mësipërme jepen për të gjithë aktivitetin e shoqërisë”Alstezo” sha, dhe nuk janë të përcaktuara në veçanti për çdo vendodhje të veprimtarisë ku ushtrohet ky aktivitet (bashkëngjitur dokumentat përkatës sa më sipër të paraqitura në plotësim të kësaj kërke në SPE të APP).

3.Lidhur me pretendimin që Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 4 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Licenca VII 3B 1(a,b,c,ç) per servisin Qarkun e Vlorë sqarojmë si më poshtë vijon:

Në kriteret e veçanta të kualifikimit për këtë lot është kërkuar si vijon:

Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencën VII.3.B.1, për pikat a, b, c, ç, sipas udhëzimit nr. 1546, datë 29.03.2016 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”

Në plotësimin e këtij kriteri nga an jonë janë paraqitur liçencat përkatëse për ushtrimin e aktivitetit të autoriparimit sikurse kërkohet në dt. (bashkëngjitur dokumentat përkatës sa më sipër të paraqitura në plotësimin të kësaj kërke në SPEtë APP)

Sa m ësipër pretendimi në lidhje me këtë pikë nuk qëndron.

4.Lidhur me pretendimin që për pikën 3 dt,- Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 6 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Leje mjedisit e tipit B për servisin në qarkun e vlorë

Në dst shtojca 8 2. Kriteret e veçanta të kualifikimit kërkohet si vijon : Operatori ekonomik ofertues, në lidhje me repartin e bojatisjes së mjeteve, duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të tipit B, Kodi III.1.B, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet. Në

plotësimin ekësaj pie kemi paraqitur Liçencën mjedisore të tipit B, Kodi III 1.B. (bashkëngjitur dokumenti sa më sipër të paraqitura në plotësimin të kësaj kërkesë në SPETë APP). Ndërkohë në pikën 3.3. kapaciteti teknik kërkohet: 5.Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon të paktën 1 (një) ambient sipërfaqe minimale 100 m2, ku ushtron veprimtarine për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, brenda qarku Vlorë, Sa më sipër sqarojm AK në kërkesën e saj për servis është shprehur qartë që kërkon: 5.Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon të paktën 1 (një) ambient sipërfaqe minimale 100 m2, ku ushtron veprimtarine për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, brenda qarku Korçë.... dhe për këtë pikë neplotësojmë kur kemi paraqitur dokumentacionin e kontratës së qirasë së servisit në Qarkun e Vlorës.

Ndrësa përta i përket bojatisjes së mjeteve AK është shprehur qartë në kërkesën e tij që: 6.Operatori ekonomik ofertues, në lidhje me repartin e bojatisjes së mjeteve, duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të tipit B, Kodi III.1.B, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet. Por në asnjë rast nuk është shprehur që ky repart të jetë në Qarkun Vlorë pasi ky repart është një reapt i veçantë dhe i specializuar, i cili shërben vetëm në rastet e bojatisjes së mjeteve. Ndërkohë ne si oe e kemi këtë repart dhe njëkohësisht jemi të pajisur me leje mjedisi të tipit B, Kodi II.1.B. sikurse kërkohet në DST nga ana e AK. Sa i përket transportit të mjeteve për kryerje e procesit të lyerjes së mjeteve, ne si oe duke qënë se ky është një repart i specializuar, në çdo rast që lind nevoja bëjmë të mundur transportin e mjeteve me karrotrec, sikurse është kërkuar në DT për mjetet e difektuara me shpenzimet tona, gjë të cilin e kemi shprehur në deklaratën e kërkuar nga ana e AK dhe që shërben pikërisht edhe në plotësimin ekëtij kriteri (bashkëngjitur dokumentat përkatës sa më sipër të paraqitura në plotësimin të kësaj kërkesë në SPE të APP).

Sa më sipër pretendimi i AK në lidhje me këtë pikë nuk qëndron.

Në përfundim sa më sipër kërkojmë riklasifikim të ofertave duke bërë të mundur klasifikimin e ofertës sonë pasi i plotëson të gjitha kërkesat e vendosura nga AK në kushtet e veçanta të kualifikimit të paraqitura në dt.[...]

Ne përfundim, sa me siper kerkuam riklasifikim te ofertave duke here te mundur klasifikimin e ofertës tone, pasi i plotësojmë të gjitha kërkesat e vendosura nga AK në Kushtet e Veçanta të kualifikimit, për paraqitura në DT

Nga ana e tij Autoriteti Kontraktor ABP, ka kthyer pergjigjen e tij ne shkresen me Nr.1088/3 Prot., dt.22.06.2020.

Në këtë shkresë AK nëpërmjet Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave ka pranuar pjesërisht ankimin tonë.

Konkretisht nga AK nuk është pranuar pretendimi si vijon:

Ne dokumentat e tenderit, Shtojca 8 KRITERET E VECANTA TE KUALIFIKIMIT, për pikën 3.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike të DT - Operatori ekonomik nuk përmbusli pikën 6 të kapacitetit ligjor/profesional i operatoreve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Leje mjedisit e tipit B për servisit në qarkun e Vlores, sqarojme si me poshte:

E kundërshtojme këtë pretendim të AK lidhur me plotësimin e kërkesës së vendosur në këtë kriter, me argumentimin si me poshte:

Ne DST, Shtojca Shtojcën 8, 2. KRITERET E VECANTA TE KUALIFIKIMIT, kërkohet si vijon:

- Ne pikën 3.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike:

*Operatori ekonomik ofertues, ne lidhje me repartin e bojatisjes se mjeteve, duhet te jete i pajisur me leje mjedisore te tipit B, Kadi 111.1.B, leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB), per vendin ku ushtron kete aktivitet.*

*Ne plotesim te kesaj pike ne kemi paraqitur Lejen mjedisore te tipit B, Kodi III. 1 .B (bashkengjitur dokumenti i paraqitur ne plotesim te kesaj kerkese ne SPE te APP).*

*Nderkohe ne piken 3.3 Kapaciteti teknik kerkohet, si vijon:*

*5. Operatori ekonomik duhet te provoje se disponon te pakten 1 (nje) ambient siperfaqe minima le 100 ni, ku ushtron veprimtarine per kryerjen e sherbimit te riparimit dhe mirembajtjes se automjeteve, brenda qarku Vlore....*

*Sa me siper, sqarojme se AK ne kerkesen e saj per servis eshte shprehur qarte qe kerkon:*

*“Operatori ekonomik duhet te provoje se disponon te pakten 1 (nje) ambient siperfaqe minima le 100 m2, ku ushtron veprimtarine per kryerjen e sherbimit te riparimit dhe mirembajtjes se automjeteve, brenda qarku Vlore.” dhe per kete pike nee plotesojme kur kemi paraqitur dokumentacionin e pronesise se Servist ne Qarkun e Vlores.*

*Ndersa persa i perket bojatisjes se mjeteve, AK eshte shprehur qarte ne kerkesen e tij qe:*

*3.1. 6" Operatori ekonomik ofertues, ne lidhje me repartin e bojatisjes se mjeteve, duhet te jete i pajisur me leje mjedisore te tipit B, Kodi III.1.B. leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB), per vendin ku ushtron kete aktivitet.”*

*Lidhur me kete kerkese te vendosur nga ana e AK, ne asnje rast nuk eshte shprehur qe ky repart te jete patjeter ne Qarkun Vlore, pasi ky repart eshte nje repart i vecante dhe i specializuar, i cili sherben vetem ne rastet e bojatisjes se mjeteve. Nderkohe, ne si OE e kemi kete repart dhe njekohesisht jemi te pajisur me leje mjedisi te tipit B, Kodi 11.1.B, sikurse kerkohet ne DST nga ana e AK. Sa i perket transportit te mjeteve per kryerjen e procesit te lyerjes se mjeteve, ne si OE, duke qene se ky eshte nje repart i specializuar, ne cdo rast qe lind nevoja bejme te mundur transportin e mjeteve me karroatrec, sikurse eshte kerkuar ne DT per mjetet e difektuara me shpenzimet tona, gje te cilen e kemi shprehur ne deklaraten e kerkuar nga ana e AK dhe qe sherben pikerisht edhe ne plotesim te ketij kriteri (bashkengjitur dokumenti i paraqitur ne plotesim te kesaj kerkese ne SPE te APP).*

*Në përfundim, sa më sipër kërkojmë riklasifikim të ofertave duke bërë të mundur klasifikimin e ofertës tonë, pasi i plotëson të gjitha kërkesat e vendosura nga AK në KUSHTET E Veçanta të kualifikimit të paraqitura në DT. [...]*

**Për Lotin IX**

*[...] Kemi marre pjese ne proceduren e zhvilluar nga AK Agjensia e Blerjeve te Perqendruara me dt.26.05.2020 Loti IX “Riparim, mirëmbajtje automjetesh për Drejtorinë e Spitalit Bashkiak “Ihsan Cabej” Lushnje”, me fond limit 4,048,050 lekë (pa TVSH). Jemi njohur ne Sistemin elektronik te Prokurimit Publik me klasifikimin e ofertave me dt.11.06.2020, ne te cilin ne si Operator Ekonomik jemi skualifikuar me aresyetimin, si vijon:*

1. Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 1 të Kriterëve të Përgjithshme të Pranimiit/Kualifikimit pasi “Deklarata mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme” nuk është sipas formës së përcaktuar në DT për pikën 3 të saj.

2. Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 6 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Leje mjedisit e tipit B për servisn në qarkun e Fier.

Klasifikimin e mësipërm e kemi kundështuar në AK, nëpërmjet Ankimimit tonë me nr. 15/1prot datë 15.06.2020, të dorëzuar në AKmë datë 15.06.2020, Nr. 3 prot., i lidhur me skualifikimin e ofertës tonë të paraqitur në këtë proçedurë prokurimi me arsyetimin si vijon:

1. Lidhur me pretendimin që “Deklarata mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme” nuk është sipas formës së përcaktuar në DT, theksojmë që dokumenti i dorëzuar sëbashku me ofertën në plotësim të kësaj kërke nga ana jonë si oe në këtë proçedurë prokurimi është konform shtojcës 7 të dokumentave Standarte (DST) të publikura nga APP për proçedurën e hapur Shërbime” bashkëngjitur dokumentii paraqitur në plotësimin e kësaj kërkesë në SPE të APP-së. Sa më sipër pretendimi i AK-së nuk qëndron.

3. Lidhur me pretendimin që Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 6 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 6 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Leje mjedisit e tipit B për servisn në qarkun e Fier sqarojmë si më poshtë:

Në kriteret e veçanta të kualifikimit për këtë lot është kërkuar si vijon:

6. Operatori ekonomik ofertues, në lidhje me repartin e bojatisjes së mjeteve, duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të tipit B, Kodi III.1.B, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet.

Në plotësim të kësaj pike kemi paraqitur Lejen mjedisore tipi B Kodi III.1.B. (bashkëngjitur dokumenti i paraqitur në plotësimin e kësaj kërkesë në SPE TË App-SË.

Ndërkohë në pikën 3.3. Kapaciteti teknik kërkohet:

5. Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon të paktën 1 (një) ambient sipërfaqe minimale 100 m2, ku ushtron veprimtarinë për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, brenda qarku Fier, dhe për këtë pikë ne e plotësojmë kur kemi paraqitur dokumentacionin e pronësisës së servisit qarku Fier.

Ndërsa përse i përket bojatisjes së mjeteve AK është shprehur qartë në kërkesën e tij që:

6. Operatori ekonomik ofertues, në lidhje me repartin e bojatisjes së mjeteve, duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të tipit B, Kodi III.1.B, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet.

Por në asnjë rast nuk është shprehur që ky repart të jetë patjetër në qarkun Fier, pasi ky repart është një repart i veçantë dhe i specializuar i cili shërben vetëm në rastet e bojatisjes së mjeteve. Ndërkohë ne si oe e kemi këtë repart dhe njëkohësisht jemi të pajisur me leje mjedisi të tipit B Kodi II.1.B. sikurse

kërkohet në DST nga ana e AK. Sa i përket transportit të mjeteve për kryerjen e procesit të lyerjes së mjeteve, ne si oe duke qënë se ky është një reupart i specializuar, në çdo rast lind nevoja bëjmë të mundur transportin e mjeteve me karrotrec, sikurse është kërkuar në DT për mjetet e difektuara me shpenzimet tona, gjë të cilën e kemi shprehur në deklaratën e kërkuar nga ana e AK-së dhe që shërben pikërisht edhe në plotësimin e këtij kriteri (bashkëlidhur dokumenti i paraqitur në plotësimin të kësaj kërkesë në SPE të APP-së.[...]

Në përfundim sa më sipër kërkohet riklasifikimin e ofertave duke bërë të mundur klasifikimin e ofertës tonë pasi i plotëso të gjitha kërkesat e vendosura nga AK në kushtet e veçanata të kualifikimit të paraqitura në DT.

Nga ana e tij Autoriteti Kontraktor ABP, ka kthyer pergjigjen e tij ne shkresen me Nr.1087/3 Prot., dt.22.06.2020.

Në këtë shkresë AK nëpërmjet Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave ka pranuar pjesërisht ankimin tonë.

Konkretisht nga AK nuk eshte pranuar pretendimi si vijon:

Ne dokumentat e tenderit, Shtojca 8 KRITERET E VECANTA TE KUALIFIKIMIT, per piken 3.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike te DT - Operatori ekonomik nuk permbusli piken 6 te kapacitetit ligjor/prefesional i operatoreve ekonomik pasi nuk arriti te paraqese Leje mjedisit e tipit B per servisin ne qarkun e Fier, sqarojme si me poshte:

E kundërshtojme kete pretendim te AK lidhur me plotësimin e kërkeses se vendosur ne kete kriter, me argumentimin si me poshte:

Në kriteret e veçanta të kualifikimit për këtë lot është kërkuar si vijon:

6.Operatori ekonomik ofertues, në lidhje me repartin e bojatisjes së mjeteve, duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të tipit B, Kodi III.1.B, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet.

Në plotësim të kësaj pike kemi paraqitur Lejen mjedisore tipi B Kodi III.1.B. (bashkëngjitur dokumenti i paraqitur në plotësimin e kësaj kërkesë në SPE TË App-SË.

Ndërkohë në pikën 3.3. Kapaciteti teknik kërkohet:

5.Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon të paktën 1 (një) ambient sipërfaqe minimale 100 m2, ku ushtron veprimtarine për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, brenda qarku Fier,dhe për këtë pikë ne e plotësojmë kur kemi paraqitur dokumentacionin e pronësisësë servisit qarku Fier.

Ndërsa përsa i përket bojatisjes së mjeteve AK është shprehur qartë në kërkesën e tij që:

6. Operatori ekonomik ofertues, në lidhje me repartin e bojatisjes së mjeteve, duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të tipit B, Kodi III.1.B, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet.

Por në asnjë rast nuk është shprehur që ky reupart të jetë patjetër në qarkun Fier, pasi ky reupart është një reupart i veçantë dhe i specializuar i cili shërben vetëm në rastet e bojatisjes së mjeteve. Ndërkohë ne si oe e kemi këtë reupart dhe njëkohësisht jemi të pajisur me leje mjedisi të tipit B Kodi II.1.B. sikurse kërkohet në DST nga ana e AK. Sa i përket transportit të mjeteve për kryerjen e procesit të lyerjes së mjeteve, ne si oe duke qënë se ky është një reupart i specializuar, në çdo rast lind nevoja bëjmë të

*mundur transportin e mjeteve me karrotrec, sikurse është kërkuar në DT për mjetet e difektuara me shpenzimet tona, gjë të cilën e kemi shprehur në deklaratën e kërkuar nga ana e AK-së dhe që shërben pikërisht edhe në plotësimin e këtij kriteri (bashkëlidhur dokumenti i paraqitur në plotësimin të kësaj kërkesë në SPE të APP-së.[...]*

*Në përfundim sa më sipër kërkojmë riklasifikimin e ofertave duke bërë të mundur klasifikimin e ofertës tonë pasi i plotëso të gjitha kërkesat e vendosura nga AK në kushtet e veçanata të kualifikimit të paraqitura në DT.[...]*

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 1297/1prot., datë 06.07.2020, protokolluar me tonën në datën 08.07.2020, shkresës nr. 1371/1 prot., datë 07.07.2020, protokolluar me tonën në datën 10.07.2020, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me argumentin se *“Për Lotin VIII 4.Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 6 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Leje mjedisit e tipit B për servisin në qarkun e Vlorë*

*Për Lotin IX 2.Operatori ekonomik nuk përmbush pikën 6 të kapacitetit ligjor/prefesional i operatorëve ekonomik pasi nuk arriti të paraqesë Leje mjedisit e tipit B për servisin në qarkun e Fier”,* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 (loti VIII; loti IX) *“Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”,* në pikën 2.3.6 *“Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:”,* të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar si më poshtë vijon:

Për Lotin VIII

1. Operatori ekonomik ofertues, në lidhje me repartin e bojatisjes së mjeteve, duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të tipit B, Kodi III.1.B, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet.

Për Lotin IX

1. Operatori ekonomik ofertues, në lidhje me repartin e bojatisjes së mjeteve, duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të tipit B, Kodi III.1.B, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet.

III.1.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) (loti VIII; loti IX) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ankimues “Alstezo” shaka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

*Për Lotin VIII*

- i. Licencë Kodi VII.3.B.3 (+) –a) Tregtimi i pjesëve të këmbit të mjeteve rrugore me motor dhe ose të rimorkiove. b) Tregtimi i pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe ose të rimorkiove të autorizuar nga prodhuesi.*
- ii. Licencë Kodi VII.3.B.1 –a) Riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit , të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, b) Riparim dhe mirëmbajtje e karrocërisë të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove , c) Riparimi dhe mirëmbajtja e impiantit elektrik të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, ç) Riparimi dhe mirëmbajtja e gomave të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove. D) Blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkio.*
- iii. Leje Mjedisore Kodi III.1.B subjktit Alstezo Për ndikim në Mjedis : Leje Mjedisore e tipit B për aktivitetin: Rinngjyrosje ose risprucim i mjeteve të transportit rrugor ose pjesëve të tyre; Lyerja dhe lustrimi i makinave; Riparim i pajisjeve motorike dhe moocikletave; Larje dhe pastrim mjetesh motorike;*

*Për Lotin IX*

- i. Licencë Kodi VII.3.B.3 (+) –a) Tregtimi i pjesëve të këmbit të mjeteve rrugore me motor dhe ose të rimorkiove. b) Tregtimi i pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe ose të rimorkiove të autorizuar nga prodhuesi.*
- i. Licencë Kodi VII.3.B.1 –a) Riparimi dhe mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit , të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, b) Riparim dhe mirëmbajtje e karrocërisë të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove , c) Riparimi dhe mirëmbajtja e impiantit elektrik të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove, ç) Riparimi dhe mirëmbajtja e gomave të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove. D) Blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkio.*
- ii. -Leje Mjedisore Kodi III.1.B subjktit Alstezo Për ndikim në Mjedis : Leje Mjedisore e tipit B për aktivitetin: Rinngjyrosje ose risprucim i mjeteve të transportit rrugor ose pjesëve të tyre; Lyerja dhe lustrimi i makinave; Riparim i pajisjeve motorike dhe moocikletave; Larje dhe pastrim mjetesh motorike;*

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbyllur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

III.1.4. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë



të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.1.5. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 28 “Kontratat e Shërbimeve” pika 5 përcaktohet se: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon “a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të procedurës objekt shqyrtimi, konstatohet se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit të dokumentave të tenderit ka kërkuar për lotin VIII; lotin IX shprehimisht që “1.Operatori ekonomik ofertues, në lidhje me repartin e bojatisjes së mjeteve, duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të tipit B, Kodi III.1.B, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet”. Nga verifikimi i ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimes rezulton se, dokumentacioni i paraqitur për plotësimin e kriterit të mësipërm nuk ka mangësi, konkretisht, operatori ekonomik “Alstezo” sh.p.k., për të vërtetuar plotësimin e kriterit sa më sipër ka paraqitur Lejen Mjedisore Kodi III.1.B. Sa më sipër, nisur nga arsyeja e skualifikimit si dhe kërkesa e përcaktuar në kriterin e mësipërm, operatori ekonomik “Alstezo” sh.p.k., me dokumentacionin e paraqitur si mësipërm arrin të përmbushë kriterin për leje mjedisore të tipit B, Kodi III.1.B, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet. Lidhur me pretendimin e autoritetit kontraktor mbi vendndodhjen e kryerjes së veprimtarisë të përcaktuar në Lejen Mjedisore Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se autoriteti kontraktor në përcaktimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit të dokumentave të tenderit ka kërkuar leje mjedisore të tipit B, Kodi III.1.B, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për vendin ku ushtron këtë aktivitet dhe në asnjë moment nuk ka kërkuar apo lidhur këtë të fundit me lotin ku merr pjesë operatori ekonomik pjesmarrës i mundshëm apo vendin konkret të kryerjes së shërbimit objekt prokurimi. Në këtë kuptim lidhur me arsyen e skualifikimit të dhënë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave e më pas shqyrtimi i ankesës së operatorit ekonomik ankimes në lidhje me këtë pikë nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pranë autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është kryer mbi bazën e një kriteri të pakërkuar nga autoriteti kontraktor, duke qenë se ky i fundit nuk e ka parashikuar këtë kriter në DST. Në sa më sipër, Komisioni gjykon se arsyeja e skualifikimit në fjalë, e cila është bazuar mbi një kriter të pakërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, është e pavlefshme. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatori ekonomik “Alstezo” sha ka përmbushur kriterin e kualifikimit, të kërkuar në dokumentat standarte të tenderit nga autoriteti kontraktor.

Rrjedhimisht pretendimi i ankimesit “Alstezo” sha qëndron

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.

596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Alstezo” sha, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur-Marrëveshje kuadër”, me nr. REF-56565-04-22-2020, me objekt: Loti VIII “Riparim, mirëmbajtje automjetesh për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Sarandë”, me fond limit 4,968,474 lekë (pa TVSH), me nr. REF-56567-04-22-2020, me objekt: Loti IX “Riparim, mirëmbajtje automjetesh për Drejtorinë e Spitalit Bashkiak “Ihsan Cabej” Lushnje”, me fond limit 4,048,050 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 26.05.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Alstezo” sha, duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve të vëre në dijëni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifave financiare të paguara nga operatori ekonomik “Alstezo” sha.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 670 Protokolli;Datë 29.06.2020**

**Nr. 671 Protokolli;Datë 29.06.2020**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**